

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SafeTech" sh.p.k

Sot më datë 05.03.2025 përpilohet ky statut në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) si dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"(i ndryshuar), krijohet shoqëria tregtare "SafeTech" SH.P.K, e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Krijohet shoqëria tregtare e emërtuar "SafeTech sh.p.k", me ortak të vetëm:

- Shoqëria Tregtare e krijuar do të ketë statusin juridik Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj tregtar është SafeTech. Kjo shoqëri është e themeluar nga Z.Orgen Hilaj, një ortak i vetme i cili zotëron 100% të vlerës së kuotave të shoqërisë duke patur rolin e ortakut themelues të vetme.

- Ortaku/Administrator **Z.Orgen Hilaj**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 22/06/1998, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Nr.Personal J80622040M.

NENI 1
LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË

Shoqëria Tregtare e krijuar do të ketë statusin juridik Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj tregtar është "SafeTech" sh.p.k. Kjo shoqëri është e themeluar nga unë Z.Orgen Hilaj, një ortak i vetëm i cili zotëron 100% të vlerës së kuotave të shoqërisë duke patur rolin e ortakut themelues të vetme.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Zyra Qendrore e shoqërisë tregtare "SafeTech" sh.p.k e ka vendodhjen në Rruga "Irfan Tomini", Hyrja 2, Apartamenti 5, Zonë Kadastrale 8260, Tiranë.

NENI 3
REGJIMI JURIDIK

Shoqëria është shqiptare dhe me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria "SafeTech" sh.p.k fiton personalitetin juridik që në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "SafeTech" sh.p.k do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj tregtare :

Shërbime marketingu, konsulencë për strategji digjitale, menaxhimin e mediave sociale, krijimin dhe mirëmbajtjen e faqeve të internetit dhe realizimin e fushatave reklamuese online, përmirësimin e performancës së marketingut përmes kanaleve digjitale. Gjithashtu shoqëria "SafeTech" sh.p.k do të ofrojë shërbime të tjera informatike.

NENI 5
KOHËZGJATJA

Shoqëria "SafeTech" sh.p.k do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkaku të ligjshëm.



NENI 6
KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "SafeTech" sh.p.k përbëhet prej 100.000 (një qind mijë) lekë, i përbërë nga 1 kuotë e cila zotërohet 100% nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Z. Orgen Hilaj.

NENI 6
PJESËMARRJET NË KAPITALIN THEMELTAR

Pjesëmarrjet e ortakëve ne kapitalin themeltar percaktohet ne raport te drejte me kontributet e tyre në kapitalin themeltar. Të drejtat, perfshire edhe te drejtat e votes, u takojnë ortakeve ne menyre perpjesetimore me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin themeltar.

NENI 7
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet me vendim te Asamblese se Ortakeve, por asnjehere nuk mund te zvogelohet nën nivelin e kapitalit fillestar të derdhur.

NENI 8
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a. Kontributit fillestar;
- b. Shitblerjes;
- c. Trashegimise;
- d. Dhurimit;
- e. çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Ortaket mund te shesin pjesërisht apo tërësisht kuotat e tyre te kapitalit. Shitja e kuotave tek të tretët bëhet vetem pasi të kete marrë vendim Asambleja e Ortakëve dhe nëpërmjet kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit.

NENI 9
ADMINISTRIMI

Administrator i Shoqërisë "SafeTech" sh.p.k i emëruar nga Asambleja e Ortakut të Vetëm është Z. **Orgen Hilaj** me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

NENI 10
ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve;
- Administratori

NENI 11
ORGANI VENDIMARRËS

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë, ortakët vendosin mbi çështjet që i rezervohen nga ligji ose nga ky Statut, si dhe mbi çështjet që njeri ose disa prej administratorëve i paraqesin per miratim.



NENI 12
MBLEDHJA E ASAMBLESE

Asambleja e Pergjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut dhe në rastet e percaktuara nga ligji nr. 9901, dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligje te tjera dhe çdo here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Takimi i rregullt i Asamblese së Pergjithshme është bërë të paktën një herë në vit.

NENI 13
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka te gjitha kompetencat per administrimin e zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm te shoqerise, me perjashtim te vendimeve që ligji, statuti, akti i themelimit i rezervojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori gezon te drejta të kufizuara në lidhje me administrimin e llogarise rrjedhëse te shoqerise, vetëm ortakët e shoqerise kane të drejtën per kryerjen e çdo veprimi dhe/ose operacioni që e vlerësojnë të dobishëm për realizimin e objektit të shoqërisë.

Administratori drejton veprimtarinë e shoqerise dhe ka të drejtë që ta perfaqesoje ate në marrëdhëniet me te tretët.

Perveç asaj çka parashikohet nga ligji, Administratori ka detyren e kryerjes së veprimeve te meposhtme:

- a) Pergatit dhe harton inventarin, të llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, raportin e ecurisë se veprimtarise së shoqerise, në mbyllje të çdo viti financiar dhe së bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ja dergon Asamblesë së Ortakëve per miratim;
- b) Hartimin e projekteve te bashkimit ose të ndarjes së shoqërisë;
- c) Të informojë asamblenë mbi zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e operacioneve tregtare me rendësi per shoqerine;
- d) Të raportojë përpara Asamblesë së Ortakëve mbi faktet qe mund të kene pasoja negative mbi ecurinë apo ekzistencen e shoqerise;
- e) Administratoret mund te delegojne perfaqesues të posacem per kryerjen e akteve te veçanta ose të nje kategori aktesh, duke percaktuar kompetencat perkatese;
- f) Të thërrasë Asamblenë e Ortakëve ne rastet e parashikuara me ligj;
- g) Si dhe çdo të drejtë tjetër e cila është percaktuar me ligj për arritjen e qëllimit të shoqërisë.

NENI 14
VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

NENI 15
SHPËRNDARJA E FITIMIT

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit dhe nga ana tjetër jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme. Ky fitim i perket ne masen 100% Ortakut te Vetem te saj.

NENI 16
LIKUJDIMI



Në këtë rast Ortaku i Vetëm marr vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyren e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likujdatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesen shtesë "shoqëri në likujdim e sipër. Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm.

NENI 17
VULA

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 18
ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponoheshë në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshme Tiranë.

Ky Statut u hartua ne 2 (dy) kopje në gjuhen shqipe.

ORTAK I VETËM I SHOQËRISË "SAFETECH" SH.P.K"
ADMINISTRATOR
Z. Orgen Hilaj

Orgen Hilaj

